



VENDIM

Nr. 4, Datë 15.05.2012

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QERA TË DISA MJEDISEVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Këshilli i Administrimit i Universitetit të Arteve në mbledhjen e tij të datës 15.05.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve,

VËREN SE

Vendimi nr. 529, datë 08.06.2011 i Këshillit të Ministrave përcakton kriteret, procedurat dhe mënyrën e dhënies me qira të pasurisë shtetërore. Universiteti i Arteve në vijimësi ka lidhur kontrata qiraje me disa subjekte private, me qëllim grumbullimin e të ardhurave për nevoja të institucionit. Kontratat e qirasë janë lidhur me afat 1 vjeçar dhe kanë pasur si objekt dhënien me qira të mjediseve brenda territorit të Universitetit të Arteve, mjedise të cilat janë me sipërfaqe nën 100m². Procedurat e ndjekura për dhënien me qira të mjediseve të UART janë bazuar në Vendimet e KM të nxjerra për këtë qëllim, në bazë të cilave është përcaktuar edhe vlera e qirasë për secilën kontratë.

Aktualisht UART ka kontrata qiraje me Vodafone Albania sh.a., Eagle Mobile sh.a., AMC sh.a. dhe Corner sh.p.k.

Duke qenë se VKM nr. 529 e sipërcituar përcakton se miratimi i dhënies me qira i mjediseve bëhet nga organi drejtues i institucionit, Këshilli i Administrimit,

VENDOSI

1. Miratimin e dhënies me qira të mjediseve në UART, sipas Lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Vlera e qirasë përcaktohet në Kontratën e qirasë, sipas VKM nr. 529, datë 08.06.2011.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE



LIDHJA 1

Nr.	Përshkrimi i pasurisë
1.	Mjedis në këndin jugor të territorit UART, në kryqëzimin e Rrugës Lekë Dukagjini me Rrugën Ibrahim Rugova, me sipërfaqe 70m ² .
2.	Sipërfaqe prej 30m ² në tarracën e ndërtesës së UART (godina e quajtur ish-administrata).
3.	Sipërfaqe prej 70m ² në tarracën e ndërtesës së UART (godina e quajtur ish-administrata).
4.	Sipërfaqe prej 40m ² në tarracën e ndërtesës së UART (godina e quajtur ish-administrata).